



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

Procesverbal

Nga mbledhja e Kuvendit të Jashtëzakonshëm të FPPK-së e mbajtur me 18.03.2026, në Hotel International në Prishtinë me fillim nga ora 15:00 .

Në mbledhje ishin prezent përfaqësues vijues të klubeve:

1. Ridvan Hashani: Kpp Ahmet Hoxha F
2. Ardian Lamaxhema: Kpp Ahmet Hoxha MK
3. Veton Gota: Kpp Bashkimi
4. Jeton Oruçi: Kpp Dardania
5. Gani Pireva: Kpp Drita M
6. Sabit Gashi: Kpp Dukagjini
7. Adhurim Bllaca: Kpp Gjilani F
8. Selami Latifaj: Kpp Gjilani M
9. Arton Haxhijaj: Kpp Istogu
10. Jahja Tërmkolli: Kpp Kosovari
11. Remzi Shala: Kpp Kvpp Prizreni
12. Rifat Rifati: Lidhja e Prizrenit
13. Besim Hajdari: Kpp Liria
14. Sheremet Hoti: Kpp Llapusha
15. Nita Baymak: Kpp Ponte Prizren
16. Nehat Çitaku: Kpp Shkolla
17. Erroll Karabaxhak: Kpp Shkolla Prizreni
18. Fadil Beqa: Kpp Shpresa
19. Alp Baymak: Kpp Sharri
20. Bekim Fazlija: Kpp Skenderaj
21. Bahri Limolli: Kpp Ulpiana

Klubi pa të drejtë vote

1. Berkan Baymak: Kpp Kalaja Pz

Munguan përfaqësuesit e klubeve

1. Alban Hoxha: Kpp Ahmet Hoxha
2. Jeton Azizi: Kpp Artana
3. Egzona Zeqiri: Drita F
4. Tahir Hamzaj: Kpp Fitorja Klinë
5. Ylli Maloku: Kpp Gani Maloku
6. Argjent Ferati: Kpp Hasan Prishtina

7. Burim Kuçi: Kpp Juniku
8. Qamil Vishaj: Kpp Maestro
9. Gani Zeneli: Kpp Peja F
10. Kreshnik Dacaj: Kpp Shqiponjat e zeza
11. Fitim Krasniqi: Kpp TTC Ferizaj
12. Hekuran Podrimçaku: Kpp Vitomirica
13. Petrit Drenica: Kpp Vushtrria
14. Leoresa Imeri: Kpp Vushtrria F
15. Kpp Priping
16. Kpp Prishtina
17. Kpp Prishtina F

Pjesëmarrës tjerë: Fadil Luta-Sekretar i përgjithshëm, Alban Azemi-nënkryetar, Albana Krasniqi: zyrtare për administratë dhe financa, Rrita Mulaj-zyrtare për media dhe marketing, Leart Sveqlla -Ekspert për Hartimin e Politikave dhe Projekteve Zhvillimore, Samire Jupolli-fotografe, si dhe disa pjesëtarë të klubeve dhe Idriz Prestreshi, kryetari i Bordit të Apelit

Kuvendi u monitorua nga dy përfaqësues nga MKRS: Aferdita Fazlija dhe Shkelqim Sadriu, si dhe përfaqësuesja nga KOK-u Teuta Beselica.

Rendi i ditës

i miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FPPK-së

1. Hapja e Kuvendit të Jashtëzakonshëm;
2. Verifikimi i mandatit të delegatëve dhe konstatimi i kuorumit;
3. Shqyrtimi i kërkesës për mocion mosbesimi ndaj Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv të FPPK-së;
 - Paraqitja dhe arsyetimi i mocionit nga përfaqësuesi i nismëtarëve
 - Shpalosja e punës njëvjeçare
 - Diskutimi i delegatëve lidhur me mocionin
4. Votimi për mocionin e mosbesimit për shkarkimin e Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv të FPPK-së.
5. Mbyllja e Kuvendit.

Pika 1.

Hapja e Kuvendit të Jashtëzakonshëm

Kryetari, fillimisht, i përshëndeti të pranishmit dhe kërkoi nga Sekretari që të bëjë verifikimin e korumit, duke konstatuar numrin e delegatëve të pranishëm në sallë.

Pika 2.

Verifikimi i mandatit të delegatëve dhe konstatimi i kuorumit

Pas verifikimit, u konstatua se ekziston kuorumi për mbajtjen e Kuvendit, pasi ishin të pranishëm 21 pjesëmarrës me të drejtë vote, nga gjithsej 38 përfaqësues të klubeve anëtare të FPPK-së. (Kpp Sharri pas plotësimit të dokumentacionit sipas vendimit të kuvendit të dates 09 mars i jepet e drejta e votes)

Kryetari: Meqenëse ekziston korumi dhe ka vullnet për të vazhduar, propozoj që fillimisht të procedojmë me zgjedhjen e tre anëtarëve të komisionit.

Pas diskutimeve, anëtarë të komisionit u zgjodhën: Sheremet Hoti, Rrita Mulaj dhe Ardian Lamaxhema.

Pika 3.

Shqyrtimi i kërkesës për mocion mosbesimi ndaj Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv të FPPK-së;

- Paraqitja dhe arsyetimi i mocionit nga përfaqësuesi i nismëtarëve
- Shpalosja e punës njëvjeçare
- Diskutimi i delegatëve lidhur me mocionin

Fjala iu dha Nehat Çitakut për të paraqitur dhe arsyetuar mocionin në emër të nismëtarëve.

Nehat Çitaku: Të nderuar delegatë të Kuvendit të Pingpongut të Kosovës, sot jemi këtu, fatkeqësisht jo me dëshirën tonë, por si rezultat i mosfunksionimit të qeverisjes aktuale që nga shkurti i vitit të kaluar. Për këtë arsye, kemi përgatitur një arsyetim për mocionin e mosbesimit ndaj Kryetarit dhe strukturave udhëheqëse të Federatës së Pingpongut të Kosovës.

Më 1 mars 2026 është dërguar kërkesa për mocion mosbesimi ndaj Kryetarit dhe strukturave udhëheqëse të federatës, e cila është nënshkruar nga një numër i konsiderueshëm delegatësh.

Kjo kërkesë nuk është veprim i momentit, por rezultat i një pakënaqësie të vazhdueshme lidhur me mënyrën e udhëheqjes së federatës gjatë kësaj periudhe.

Që nga marrja e mandatit në shkurt të vitit 2025, kjo strukturë udhëheqëse është karakterizuar nga mungesë e theksuar transparence. Një shembull konkret janë dy punëtoritë e organizuara nga federata, pas përfundimit të të cilave është kërkuar shpërndarja e materialeve, gjë që nuk është realizuar.

Një shqetësim tjetër serioz lidhet me funksionimin e Bordit të Federatës. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar probleme të vazhdueshme, duke filluar nga mosdërgimi i procesverbaleve tek anëtarët, deri tek marrja e disa vendimeve të rëndësishme pa siguruar kuorumin e nevojshëm, në kundërshtim me Statutin dhe rregulloret e federatës.

Pakënaqësi janë shfaqur edhe gjatë shpalljes së laureatëve për vitin 2025, ku sipas reagimeve të shumta nga komuniteti i pingpongut, nuk janë respektuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara në rregulloren përkatëse të federatës.

Të gjitha këto çështje së bashku kanë krijuar një mungesë të thellë besimi brenda komunitetit të pingpongut dhe, për këtë arsye, është paraqitur ky mocion.

Kryetari: Meqenëse është paraqitur mocioni, më lejoni që edhe unë të bëj një përmbledhje të punës njëvjeçare.

Federata e Pingpongut e Kosovës gjatë vitit 2025 ka shënuar ngritje të kapaciteteve organizative, sportive dhe institucionale, duke u konsoliduar si një nga federatat më aktive dhe më dinamike në vend. Gjatë këtij viti, federata ka siguruar zhvillimin e rregullt dhe mbarëvajtjen e sistemit të garave.

Për herë të parë në historinë e Kosovës është realizuar lidhja e sportit me shkollat. Gjatë vitit 2025, federata ka përfshirë mbi 600 sportistë në nivel vendi, ndërsa janë realizuar mbi 100 aktivitete sportive, organizative dhe zhvillimore.

Një nga ngjarjet më të rëndësishme ka qenë organizimi i suksesshëm i aktiviteteve ndërkombëtare WTT Feeder dhe Youth Contender, të cilat kanë sjellë në Kosovë sportistë nga mbarë bota. Po ashtu, turneu “Prishtina Open”, i organizuar nga klubi KPP Priping me mbështetjen e federatës, ka sjellë një numër të madh sportistësh ndërkombëtarë në vend.

Në vitin 2025, përfitues të bursave kanë qenë dy sportistë, Shega Hashani dhe Blend Hajdari, ndërsa për vitin 2026 është paraparë që të jenë shtatë sportistë përfitues, gjë që nuk ka ndodhur më parë në historinë e federatës.

Federata ka investuar në mënyrë të veçantë në zhvillimin e gjeneratave të reja dhe në ngritjen e kapaciteteve sportive, duke organizuar gjashtë kampe në bashkëpunim me përfaqësuesen, përfshirë edhe një kamp me eksperte ndërkombëtare nga Sllovenia. Po ashtu, është realizuar projekti “Pingpongu në shkolla”, ku janë përfshirë 250 nxënës nga 7 shkolla, me synim zgjerimin e këtij programi në 25 shkolla deri në vitin 2030.

Një arritje veçanërisht e rëndësishme është stabilizimi dhe përmirësimi i gjendjes financiare të federatës. Në momentin kur struktura e re e Bordit Ekzekutiv mori detyrën në janar të vitit 2025, federata kishte borxhe në vlerë prej 77,995 euro ndaj furnitorëve të ndryshëm. Gjatë vitit 2025, falë organizimit të aktiviteteve ndërkombëtare dhe punës së vazhdueshme të Bordit Ekzekutiv, këto borxhe janë shlyer në tërësi.

Sot, më shumë se kurrë, federata ka nevojë për vazhdimësi, stabilitet financiar dhe zhvillim të qëndrueshëm, si dhe për mbështetje të punës së bërë. Andaj, i ftoj të gjithë delegatët që të

votojnë kundër mocionit për shkarkimin e Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv, në interes të federatës dhe të ardhmes së sportistëve.

Po ashtu, është e qartë se një pjesë e delegatëve nuk janë të pranishëm, dhe nëse veprojmë mbi baza të interesave personale sa herë që hyjmë në procese zgjedhore, atëherë rrezikohet stabiliteti financiar dhe zhvillimor i federatës.

Në fund, ju vendosni për drejtimin që dëshironi t'i jepni federatës. Unë jam këtu për t'ju shërbyer të gjithëve dhe për të vazhduar përpara, me gjithë dijen dhe kapacitetin tim, nëse ekziston vullneti për bashkëpunim.

Sheremet Hoti: Une e kam nenshkru mocionin e mosbesimit, përveç tjerat ekskulizivisht për shkeljet që ti si krytar i ke bërë statutit të Federates, në dijeni për shkeljet, siç ka qenë rasti i të punësuarve në Federat, marrja e vendimeve pa kuorum në Bord Ekzekutiv, dhe në fund ka shumë mënyra për të zgjidh problemet, por un kam zgjedh si menyrc mocionin e mosbesimi

Gani Pireva: vetëm desha të sigurohem që të gjithë kuvendarët e kanë pranuar ftesën, mendoj se do të ishte mire të ishin të pranishëm për të dëgjuar fjalën tënde.

Kryetari kërkoi nga Sekretari që edhe një herë të bëhet numërimi i delegatëve dhe më pas të kalohet në votim, duke deklaruar se nga ai moment ai do të largohej nga Kuvendi.

Sekretari filloi përsëri me numërimin dhe konstatoi se në sallë ishin të pranishëm 20 përfaqësues të klubeve me të drejtë vote, nga gjithsej 38 përfaqësues të klubeve anëtare të FPPK-së.

Meqenëse Kryetari u largua nga Kuvendi, u hap diskutimi lidhur me atë se kush duhet ta udhëheqë mbledhjen në vazhdim.

Afërdita Fazlija: Duhet që drejtimin ta marrë një anëtar i Bordit ose Nënkryetari, nëse janë të pranishëm.

Alban Azemi mori udhëheqjen e mbledhjes, e ja dha fjalën sekretarit për të proceduar.

Sekretari informoi të pranishmit se votimi duhet të bëhet: Për kalimin e mocionit ose kundër

Ridvan Hashani: propozoj që para se të fillohen me votimin për mocionin të votohet për mënyren e votimit, pas parasysh se kryetari është zgjedhur me vota të mshefta.

Sekretari: kërkoj nga të pranishmit të deklarohen nëse janë të pajtimit që votimi të jetë i hapur apo mbyllur..

Kuvendi unanimisht mori këtë:

VENDIM

- I. Votimi për mocionin e votëbesimit të kryetarit dhe anëtarëve të bordit të jetë i hapur.

Komisioni verifikues pyeti se kush është për shkarkimin e Kryetarit dhe Bordit Ekzekutiv të Federatës.

Pas numërimit të votave me 20 vota pro mocionit, asnjë kundër, asnjë abstenim kuvendi mori këtë:

VENDIM

I. Shkarkohet Kryetari dhe Bordi Ekzekutiv i Federatës.

Pas kësaj u diskutua se si do të vazhdohet tutje, sekretari theksoi se deri në kuvendin zgjedhor kuvendin e udhëheqë nënkryetari.

Nehat Çitaku theksoi se sipas statutit duhet të formohet një komision i ri pasi edhe nënkryetari është shkarkuar.

Sekretari fillimisht theksoi se kjo nuk është pjesë e statutit, por pasi gjeti nenin 18 pika 4, të cilën e lexoi për të pranishmit, u vërtetua se udhëheqja e federatës do të bëhet nga Komisioni i cili do të organizoj kuvendin zgjedhor brenda 30 ditësh.

Pas kësaj u propozuan dhe unanimisht u aprovuan në këtë komision:

- Sheremet Hoti, kryesues
- Besim Hajdari
- Ridvan Hashani

Kuvendi përfundoi në orën 16:30.



FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

Kuvendi i Jashtëzakonshëm

18/03/2026

Lista e delegatëve

Klubet me të drejtë vote

Nr	EMRI I KLUBIT	KOMUNA	DELEGATI	nr personal	Nënshkrimi
1	Kpp Ahmet Hoxha	Ferizaj	Alban Hoxha	1030661784	
2	Kpp Ahmet Hoxha F	Ferizaj	1 Ridvan Hashani	1011623421	
3	Kpp Ahmet Hoxha MK	Ferizaj	2 Ardian Lamaxhema	1003437341	
4	Kpp Artana	Novobërda	Jeton Azizi	2005828107	
5	Kpp Bashkimi	Prizren	3 Veton Gota	1230398450	
6	Kpp Dardania	Prishtina	Jeton Oruçi	1500993584	
7	Kpp Drita F	Gjilan	Egzona Zeqiri	1232110127	
8	Kpp Drita M	Gjilan	4 Gani Pireva	1012887104	
9	Kpp Dukagjini	Klinë	5 Sabit Gashi	1013478674	
10	Kpp Fitorja Klinë	Klinë	Tahir Hamzaj	1002508296	
11	Kpp Gani Maloku	Ferizaj	Ylli Maloku	1004479960	
12	Kpp Gjilani F	Gjilan	6 Adhurim Billaca	1002991132	
13	Kpp Gjilani M	Gjilan	7 Selami Latifaj	1012355005	
14	Kpp Hasan Prishtina	Vushtrri	Argjend Ferati	1231146403	
15	Kpp Istogu	Istog	8 Arton Haxhijaj	1003641046	
16	Kpp Juniku	Junik	Burik Kuçi	1173532730	
17	Kpp Kosovari	Fushëkosovë	9 Jahja Tërmlkollli	1013538073	
18	Kpp KVPP Prizreni	Prizren	10 Remzi Shala	1002693930	
19	Kpp Lidhja e Prizrenit	Prizren	11 Rifat Rifati	1002690922	
20	Kpp Liria	Prizren	12 Besim Hajdari	1016489456	
21	Kpp Llapusha	Malishevë	13 Sheremet Hoti	1030852024	
22	Kpp Maestro	Peja	Qamil Vishaj	1009287082	
23	Kpp Peja F 2020	Peja	Gani Zeneli	2013434517	
24	Kpp Ponte Prizren	Prizren	14 Nita Baymak	1173417515	
25	Kpp Priping	Prishtina			



Kuvendi i Jashtëzakonshëm
18/03/2026

Lista e delegatëve

FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION

26	Kpp Prishtina	Prishtina			
27	Kpp Prishtina F	Prishtina			
28	Kpp Shkolla	Prishtina	15	Nehat Çitaku	1004111989
29	Kpp Shkolla Prizreni	Prizren	16	Eroll Karabaxhak	1016417030
30	Kpp Shpresa	Skenderaj	17	Fadil Beqa	1008371071
31	Kpp Shqiponjat e zeza	Deçan		Kreshnik Dacaj	1008765797
32	Kpp Skenderaj	Skenderaj	18	Bekim Fazlija	1004825353
33	Kpp TTC Frizaj	Ferizaj		Fitim Krasniqi	1172478286
34	Kpp Ulpiana	Lipjan	19	Bahri Limolli	1015750606
35	Kpp Vitomirica 2024	Peje		Hekuran Podrimçaku	1003287269
36	Kpp Vushtrria	Vushtrri		Petrit Drenica	1172782708
37	Kpp Vushtrria F	Vushtrri		Leoresa Imeri	1248151426

KPP SHARI

20 ALP BAJMAK

Klubet pa të drejtë vote

Nr	EMRI I KLUBIT	KOMUNA	DELEGAT	Nënshkrimi
1	Kpp Kalaja Pz	Prizren	Berkan Bajmak	
2	Kpp Lipjani	Lipjan		

Pjesëmarrës tjerë

Nr	Emri	Pozita	Instituti	Nënshkrimi
1	Tenta Beselica	BE	KOK	1019693941
2	Alban Akari	BE		
3	Alc Bexmet		Shkurti	
4	Edi Z. Drenica	Rip. i Bredit		
5	Edi Z. Drenica			
6	Edi Z. Drenica	S. i Kl. St.		
7	Samir Jupolli			
8	Monika Jari		MERS	
9	Shkelqim Sadriu		MERS	
10				